



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 40.2 shkronja j) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 7 paragrafi 3 të Ligjit për bashkëpunim ndër komunal nr.04/L-010, dhe neneve 14, 15 paragrafi 2.4 dhe nenin 34 paragrafi 2.10 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/19, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 29 mars 2019, miratoi,

VENDIM PËR AUTORIZIMIN E KRYETARIT TË KOMUNËS PËR FILLIMIN E KONSULTIMEVE PËR THEMELIMIN E BASHKËPUNIMIT NDËR - KOMUNAL

Neni 1

z.Agim Veliu, Kryetar i Komunës së Podujevës, autorizohet për fillimin e konsultimeve për themelimin e bashkëpunimit ndër - komunal mes Komunës së Podujevës dhe Komunave; **Komuna e Prishtinës, Komuna e Vushtrrisë dhe Komuna e Obiliqit.**

Neni 2

Konsultimet me Komunat e cekura në nenin 1, dhe përgatitja e Marrëveshjes për bashkëpunim të ndërsjellë, bëhet konform Vendimit të Kuvendit të Komunës për miratimin e nismës për bashkëpunim ndër – komunal, si dhe kompetencave të parapara me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 3

Marrëveshja nënshkruhet nga Kryetari i Komunës së Podujevës, e njëjta procedohet për miratim në Kuvendin e Komunës, ndërsa bëhet e plotfuqishme pas vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushteti Lokal dhe publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 8.11 të Rregullores (QRK) nr.01/2016 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr. 01-020/05-0027760/19
Podujevë,
29 mars 2019



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi